VENDIM
Nr.39, datë 25.5.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR EKSPORT–IMPORTET E KARTËMONEDHAVE E TË MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 34 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për eksport-importet e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.83, datë 7.11.2001 "Për miratimin e rregullores "Për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare", shfuqizohet.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR EKSPORT–IMPORTET E KARTËMONEDHAVE DHE TË MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i sasisë dhe i procedurave për eksport–importin e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
a) "Monedhë" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare me ose pa kurs ligjor.
b) "Monedhë me "kurs ligjor"" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat nuk janë tërhequr nga qarkullimi dhe që shërbejnë si mjet pagese e pranohen për të gjitha pagesat e detyrimeve që individët ose subjektet e ndryshme, private ose publike, kryejnë me njëri-tjetrin.
c) "Monedhë pa "kurs ligjor"" janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të cilat janë tërhequr nga qarkullimi dhe që nuk mund të shërbejnë si mjet pagese për pagesat e detyrimeve që

individët ose subjektet e ndryshme, private ose publike, kryejnë me njëri-tjetrin.

d) "*Cash*" është gjendja fizike e monedhave, që eksportohen dhe importohen fizikisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

e) "Eksport" është nxjerrja në *cash*, nga territori i Republikës së Shqipërisë, e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

f) "Import" është futja në *cash*, në territorin e Republikës së Shqipërisë, e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike shqiptare, me ose pa kurs ligjor.

g) "Person" është çdo person juridik, sipas kuptimit që i jep neni 26 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

h) "Individ" kupton çdo shtetas, shqiptar ose të huaj, rezident ose jorezident në Republikën e Shqipërisë.

i) "Veprimtari numizmatike" është mbajtja e kartëmonedhave ose monedhave metalike me ose pa kurs ligjor, për qëllime koleksionimi dhe/ose studimi.

KREU II
IMPORTI DHE EKSPORTI I MONEDHAVE

Neni 4
E drejta ekskluzive

Importi *cash* i monedhave shqiptare me kurs ligjor, është e drejtë ekskluzive e Bankës së Shqipërisë.

Neni 5
Import–eksporti nga individët

Çdo individ ka të drejtë të eksportojë ose të importojë në *cash* monedha shqiptare me kurs ligjor nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë jo më tepër se shuma prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

Neni 6
Import–eksporti nga personat juridikë

1. Personat juridikë lejohen të eksportojnë monedha shqiptare me kurs ligjor jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë, vetëm për veprimtari numizmatike dhe për adoptim, dhe testim të makinerive dhe sistemeve përpunuese, arkëtuese dhe të livrimit automatik të kartëmonedhës e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, eksporti i monedhave shqiptare nga personat juridikë bëhet vetëm pas dhënies së autorizimit me shkrim nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë vlerëson dhe vendos për sasinë e monedhave që do të eksportohen, duke u bazuar në kërkesën e personit juridik që kërkon të eksportojë. Kërkesa duhet të përmbajë sasinë që kërkohet të eksportohet, si dhe arsyet e eksportimit.

4. Autorizimi sipas pikës 2 të këtij neni, lëshohet nga administratori përkatës, bazuar në relacionin e përgatitur nga Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë. Në çdo rast, autorizimi përmban gjithashtu edhe sasinë e monedhave që lejohet të eksportohet.

5. Në rastet e eksportit të monedhave për qëllime të adoptimit dhe të testimit të makinave dhe sistemeve përpunuese, arkëtuese dhe të livrimit automatik, shuma e eksportuar duhet të rikthehet në Shqipëri brenda 3 muajve nga data e nxjerrjes së saj. Personi i autorizuar për eksportin e kësaj shume është i detyruar të njoftojë Bankën e Shqipërisë për rikthimin e saj, duke paraqitur dokumentacionin doganor vërtetues.

6. Në rast mosrikthimi të kësaj shume, personi i cili është autorizuar për eksportin e monedhave, humbet të drejtën për të eksportuar monedha në raste të tjera.

Neni 7

Individët dhe personat juridikë mund të eksportojnë dhe të importojnë monedha shqiptare pa kurs ligjor, pa asnjë kufizim.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 8
Shfuqizime

Rregullorja "Për eksport – importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike shqiptare", e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.83, datë 7.11.2001, shfuqizohet.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.